

Kolegji Publik Ndërkombëtar i Biznesit në Mitrovicë (IBCM), Rr. Bislam Bajgora, Nn, 40000
Mitrovicë, Republika e Kosovës, www.ibcmmitrovica.eu

Nr. Prot: 345
Datë: 29/05/2024

Mbështetur në Nenin 80 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Nenin 8 të Ligjit 03/L-212 të Punës dhe bazuar në dispozitat e Statutit të Përkohshëm të Kolegjit Publik Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë (IBCM) si dhe vendimin e Këshillit Themelues, shpallë:

KONKURS I JASHTËM

1. Udhëheqës i Divizionit për Komunikim dhe Marëdhënie me Publikun

<i>Titulli i pozitës së punës</i>	<i>Udhëheqës i Divizionit për Komunikim dhe Marëdhënie me Publikun</i>
<i>Pozita</i>	<i>Administrative</i>
<i>Kohëzgjatja e kontratës</i>	<i>Me afat të pacaktuar</i>
<i>Numri i pozitave</i>	<i>1</i>
<i>Kategoria Funktionale</i>	<i>Drejtues/e i/e Ulët</i>
<i>Koeficienti</i>	<i>Koeficienti 110/7.35</i>
<i>Puna provuese</i>	<i>Punë provuese gjashtë muaj</i>
<i>Orari i Punës</i>	<i>Normë e plotë (40 orë në javë)</i>

Nëpunësi mbikëqyrës: Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit.

1. **Qëllimi i pozitës:** Kryerja e të gjitha procedurave ligjore në kompetencë të Zyrtar i Kolegjit për Komunikim dhe Marëdhënie me Publikun

Detyrat kryesore:

- Menaxhon zyrën e Komunikimit dhe Marëdhënies me Publikun.
- Zhvillon regullore dhe politika lidhur me koordinimin dhe mbarëvajtjen e zyrës së Komunikimit dhe Marëdhënies me Publikun;
- Udhëheqë, koordinon dhe ofron mbështetje stafit dhe studentëve për promovimin e aktiviteteve dhe ngjarjeve të Kolegjit.
- Krijon partneritete dhe marrëveshje të reja dhe ruan komunikimin profesional mesë Kolegjit dhe institucioneve, kompanive dhe organizatave;
- Krijon partneritete dhe aktivitete me rjetin e të diplomuarve, partnerëve të komunitetit dhe grupeve të tjera të identifikuar ;
- Menaxhon dhe azhuron postimin e dokumenteve dhe ngjarjeve në Web faqe, dhe rjetet tjera sociale të Kolegjit;
- Organizon dhe mbështet ngjarjet dhe aktiviteteve për promovimin e Kolegjit.
- Kryen edhe detyra të tjera, sipas kërkesës së mbikëqyrësit, të cilat janë në harmoni me legjislacionin, ligjet dhe me rregullat e cekura më lart.

Shkathësitë e kërkuara:

- Të ketë diplomë universitare drejtimi në degën e gazetaris, gjuhës dhe letërsisë, marketingut, ose të ngjashme;
- Të paktën 3 vite përvojë pune profesionale në fushën e komunikimit dhe ;
- Njohuri të mira të parimeve dhe praktikave në lëmin e Komunikimit dhe Marëdhënies me Publikun;
- Njohuri në fushën e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.
- Njohuri rreth legjislacionit përkatës në fuqi.
- Aftësi të shkëlqyeshme komunikuese, organizative dhe planifikuese;
- Aftësi për të trajtuar informatat e besueshme në mënyrë të duhur;
- Aftësi të shkëlqyeshme në përdorimin e kompjuterit, veçanërisht programeve MSWord, Excel dhe platformave sociale;
- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze

Dokumentet:

- Formulari për aplikim,
- Diploma (kopja e vërtetuar te Noteri),
- Dëshmitë për provojnë e punës (profesionale),
- CV-në (biografinë),
- Certifikatën e lindjes,
- Letërnjoftimin- fotokopje,
- Certifikatën penale (dëshminë që nuk jeni nën hetime).

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR PRANIMIN E ZYRTARËVE PUBLIK

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me ligjin për gjuhët;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

KRITERET E PËRGJITHSHME DHE PROCEDURAT E VLERSIMIT:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Kosovës të cilët i plotësojnë kriteret e kërkuara në këtë konkurs.

Pranimi bëhet në bazë të meritës, pasi t'i jenë nënshtruar procedurës së përzgjedhjes së përcaktuar në bazë të legjisllacionit në fuqi.

Procesi i vlersimit zhvillohet në dy faza: Verifikimi paraprak (nga njësia përgjegjëse) nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta sipas konkursit si dhe vlerësimi (nga komisioni përzgjedhës) i njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve, vlersimi i kandidatëve bëhet në gjuhën Angleze.

Totali i pikëve në procedurën e konkurrimit është 100 pike maksimale nga testi me shkrim dhe 100 pike maksimale intervista me gojë. Kandidatët duhet të arrijnë të paktën 70 pikë nga testi me shkrim dhe 70 pikë intervista me gojë që të mund të shpallen fitues sipas këtij konkursi.

Kandidat fitues do të shpallën kandidati që ka më së shumti pikë.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi, pas publikimit të njoftimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh, mbetet i hapur 30 ditë kalendarike për aplikim, duke filluar nga data 30.05.2024 deri më 28.06.2024 ora 16:00 që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Procesi i aplikimit: Aplikimi për pozitën e sipërshënuar bëhet në kopje fizike (në zarf të mbyllur) në administratën e IBCM : Address: Rr. Bislam Bajgora, Nn, 40000 Mitrovicë, Kosovë nga ora 8.00 – 16.00 si dhe në formën elektronike në adresën: ibcm_vacancy@ibcmmitrovica.eu duke shënuar në subjekt "Pozitën për të cilën aplikoni"

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar në sistemin SIMBNJ dhe në web faqen e Kolegjit Publik IBCM.